

Në bazë të nenit 38, paragrafi 1, pika 2 dhe 4 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (“Fl. zyr. MZ”, nrë 2/2018 dhe 34/19) dhe nenit 58, paragrafi 1, pikat 2 dhe 4 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës”, nr. 48/19), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më ____. ____. 2019 ka nxjerrë

VENDIMIN
PËR NXJERRJEN E PLANIT LOKAL TË PËRFSHIRJES SOCIALE TË ROMËVE
DHE EGJIPTIANËVE PËR PERIUdhËN 2020 – 2023 NË KOMUNËN E ULQINIT

Neni 1

Nxirret Plani lokal i përfshirjes sociale të romëve dhe egjiptasve në Komunën e Ulqinit për periudhën 2020 – 2023.

Neni 2

Bartës i aktiviteteve që kanë të bëjnë me arritjen e barazisë gjinore në Komunën e Ulqinit është sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani loka i përfshirjes sociale të romëve dhe egjiptasve për periudhën 2020 – 2023 në Komunën e Ulqinit që e ka hartuar Grupi punues për hartimin e Planit lokal për përfshirjen sociale të romëve dhe egjiptasve për periudhën 2020 – 2023 në Komunën e Ulqinit.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në “Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës”.

Numër: 02 –
Ulqin, më ____. ____. 2019

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

KRYETARI
Dr. Ilir Çapuni

A r s y e t i m

Baza juridike për nxjerrjen e këtij Vendimi është në nenin 38, paragrafi 1, pikat 2 dhe 4 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (“Fl. zyr. MZ”, nrë 2/2018 dhe 34/19) dhe nenit 58, paragrafi 1, pikat 2 dhe 4 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës”, nr. 48/19), me të cilët është paraparë që Kuvendi si organ i vetëqeverisjes lokale nxjerr dispozita dhe akte të tjera. Kuvendi përveç dispozitave dhe akteve të tjerë nxjerr plane dhe programe të zhvillimit dhe kryen edhe punë të tjera në pajtim me Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe ligje të tjera të posaçme.

Arsyeja për nxjerrjen e këtij Vendimi është në Strategjinë për përfshirjen sociale të romëve dhe egjiptasve në Mal të Zi për periudhën 2016 – 2020, në të cilën është paraqitur nevoja që Vetëqeverisjet lokale të përgatisin dhe aprovojnë Planet lokale të aksionit për përmirësimin e pozitës së romëve dhe egjiptasve, të harmanizuara me zhvillimin real, përgjithshëm, ekonomik dhe social të komunitetit lokal.

Plani lokal për përfshirjen sociale të romëve dhe egjiptasve për periudhën 2020 – 2023 në Komunën e Ulqinit paraqet një dokument lokal strategjik, i xili ka për qëllim t’i kontribuojë avancimit të pozitës së popullatës RE në komunën e Ulqinit, si dhe realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre të njeriut. Ky dokument paraqet një platformë të politikës lokale ndaj të gjitha çështjeve kryesore që janë të rëndësishme për integrimin thelbësor dhe të qëndrueshëm të komunitetit të romëve dhe egjiptasve në jetën publike dhe zhvillimin e komunës sonë.

Vetëqeverisja lokale dhe përfaqësuesit e saj aktivisht kanë marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti, përmes konsultimeve dhe hulumtimit të nevojave të komunitetit. Me përkrahjen e krijimit të këtij plani të aksionit dhe miratimi i tij, vetëqeverisja lokale ka treguar gatishmëri që me përkushtim dhe me strategji të punojë në përmirësimin e pozitës së romëve dhe egjiptasve dhe përfshirjen e tyre aktive në mjedisin lokal.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij dokumenti si për komunitetin RE ashtu edhe për komunitetin lokal i propozojmë Kuvendit që ta miratojë Planin e përmendur lokal dhe të nxjerrë Vendimin për miratimin e Planit lokal për përfshirjen sociale të romëve dhe egjiptasve për periudhën 2020 – 2023 në Komunën e Ulqinit.

SEKRETARIATI PËR ADMINISTRATË DHE VEPRIMTARI SHOQËRORE



Komuna e ULQINIT

(PROJEKT)

**PLANI LOKAL PËR INKLUZIONIN E
ROMËVE DHE EGJIPTIANVE PËR
PERIUDHËN NË KOMUNËN E ULQINIT**

ULQIN
Tetor, 2019

PËRMBAJTJE:

HYRJE.....	5
KORNIZA STRATEGJIKE.....	7
PARIMET E PËRPILIMIT TË PLANIT TË AKSIONIT	9
VIZIONI	10
ANALIZA SWOT.....	11
ANALIZA E SITUATËS	12
FUSHAT E IMPLEMENTIMIT	13
ÇËSHTJET STRATEGJIKE NGA FUSHA E ZBATIMIT TË LAP	23
PLANIFIKIMI AKSIONAL	26
ZBATIMI, PËRCJELLJA DHE FINANCIMI I PLANIT LOKAL TË AKSIONIT	34
MONITORIMI I REALIZIMIT TË PLANIT	35

LISTA E SHKURTICAVE

PAP – politika aktive e punësimit
QAP – Qendra për arsimimin profesional
QPS – Qendra për punë sociale
SHSH– Shtëpia e shëndetit
BE – Bashkimi evropian
ISHP – Instituti për Shëndetin Publik
IPZH – Personat intern të zhvendosur
SP – Servisi publik
PLA – Plani lokal i aksionit
PLBS – Plani lokal i banesës sociale
VL – Vetëqeverisja lokale
MDNJP– Ministria e të Drejtave Njerëzore dhe Pakicave
MZHQT– Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit
MA – Ministria e arsimit
MPPS– Ministria e Punës dhe Përkujdesjes Sociale
MPB – Ministria e punëve të brendshme
NRIS – Korniza Evropiane e Strategjisë Nacionale për Integrimin e Romëve (ang.: National Roma Integration Strategies)
OJQ – Organizata joqeveritare
OSBE – Organizata Evropiane për Bashkëpunim dhe Siguri (The Organization for Security and Co-operation in Europe)
SHF – Shkolla Fillore
IA – Institucionet e arsimit
PZH – Persona të zhvendosur
BISRESH– Baskpunëtor në inkluzionin social të romëve dhe egjiptianëve në shëndetësi
UNHCR - United Nations High Commissioner for Refugees (Komesariati i Lartë i KB për refugjatë)
DP – Drejtoria e policisë
DPR – Drejtoria për përkujdesjen për refugjatë
ZOPT – Qendra për arsimim dhe trajnim

HYRJJE

Qeveria e Malit të Zi ë vitin 2005 ka miratuar Planin Nacional të Aksionit për implementimin e Dekadës së kyçjes së romëve, me projektet në fushën e arsimit, punësimit, banimit dhe mbrojtjes shëndetësore, që duhet realizuar deri në vitin 2015. Sipas dispozitave të Dekadës Qeveria e një shteti të kyçur e merr funksionin e kryesimit të Dekadës. Në maj të vitit 2013 Mali

i Zi ka marrë kryesimin nga Republika e Kroacisë, ndërsa në qershor të vitit 2014 kryesimin ia ka dorëzuar Bosnjës dhe Hercegovinës.

Për shkak të kufizimit të veprimit të Planit aksion në katër fusha prioritare, Qeveria e Malit të Zi, në fund të vitit 2007 ka miratuar ***Strategjinë për përmirësimin e pozitës së popullatës RAE në Mal të Zi 2008-2012***, pas së cilës ka pasuar edhe tjetra, me titullin ***Strategjia për përmirësimin e pozitës së romëve dhe egjiptianëve në Mal të Zi 2012-2016***.¹

Sipas të dhënave të Entit për përkujdesjen e refugjatëve në reregjistrimin e personave të zhvendosur intern nga Kosova që banojnë në Mal të Zi, publikuar më 2009, 43 persona janë deklaruar si ashkalinjë. Për shkak të numrit të vogël të pjesëtarëve të kësaj bashkësi etnike dhe për faktin se ata nuk paraqiten si grup i posaçëm etnik në regjistrimin e popullsisë më 2011, ashkalinjtë nuk përmenden si grup i posaçëm etnik në këtë strategji. Mirëpo, pjesëtarët e këtij populli plotësisht do të përfshihen në të gjitha aktivitetet e parapara me këtë Strategji, e që burojnë nga statusi i tyre juridik.

2 Strategjia për inkluzionin social të romëve dhe egjiptianëve prej 2012 deri më 2020, Qeveria e Malit të Zi në vitin 2016 ka miratuar ***Strategjinë për inkuzionin social të romëve dhe egjiptianëve prej 2016 deri më 2020*** që mbi ndërtohet mbi dy parapraket, duke i ridefinuar prioritetet nacionale, mënyrat e zbatimit dhe ndërmarrjen e masave të posaçme në pajtim me rrethanat e ndryshuara shoqërore dhe politike, përparimin e arritur dhe sfidat e mëtejshme në procesin e integritimit dhe përmirësimit të pozitës socio-ekonomike të romëve dhe egjiptianëve. Në regjistrimin e popullsisë së Malit të Zi në vitin 2011, në komunën e Ulqinit u regjistruan 232 persona që u deklaruan me përkatësi rome dhe egjiptiane . Nga ky numër 73 u deklaruan se i takojnë grupit etnik të egjiptianëve (0,37%), ndërsa 159 është numri i banorëve që i takojnë grupit etnik rom (0,80%).

Enti për punësim – Byroja e punës në komunën e Ulqinit ka dorëzuar shkresën me numer 1201-310 me date 13.11.2019.vit, i regjistruar me numer 03-611/2019 me date 14.11.2019.vit pranë Sekretariatit për administratë dhe veprimtari shoqërore, në të cilin ceket se BP në Mal të Zi ka numer të madh masash dhe politika aktive mbi punësimin e romëve dhe egjiptianëve nga të cilat: programe elementare mbi eliminimin e analfabetizimit, përvetësimin e njohurive dhe aftësive specifike, kualifikimin, rikualifikimin, programen e veteunësimit për ndërtimin e biznesit privat, ringjellesimin e zanateve të vjetra si dhe dhënie të burimeve të pakthyeshme. Mbi bazën diskriminimit pozitiv në evidentimin e tyre kanë dhënë dhe mundësinë e deklarimit të përfaqësive etnike, por deri tani nuk kanë të evindetuar ndonjë person i cili është me përfaqësi etnike rome dhe egjiptiane.

Qendra për punë sociale në komunën e Ulqinit në bazën e vet të të dhënave nuk kanë të regjistruar persona të komunitetit rom dhe egjiptian të cilët janë shfrytëzues të MOP-it.

Sipas të dhënave jo zyrtare në Komunën e Ulqinit jetojnë rreth 500 (pesëqind) persona të cilët i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, kurse gjatë sezonit të verës numri i tyre rritet ndjeshëm.

KORNIZA STRATEGJIKE

Dokumenti kryesor në të cilin bazohet Plani i aksionit për romët dhe egjiptianit në komunën e Ulqinit 2020-2023 është Strategjia për inkluzionin social të romëve dhe egjiptianëve në Mal të Zi 2016-2020. Plani i aksionit, në rast nevojë do të revidohet periodikisht, në pajtim me nevojat dhe ndryshimet e dukshme të pozitës së popullatës rome dhe egjiptiane në përgjithësi, por në veçanti edhe pozitës së grupeve posaçërisht të përjashtuara dhe të marginalizuara brenda bashkësisë rome dhe egjiptiane (gratë, fëmijët, personat me invaliditet, personat e moshuar) në Mal të Zi.

Pajtueshmëria me dokumentet ndërkombëtare

Plani i aksionit 2020-2023 i komunës së Ulqinit është i akorduar me Kornizën evropiane për strategjitë nacionale për integrimin e romëve. Me Planin e aksionit për përmirësimin e pozitës së romëve dhe sintëve në fushën e veprimit të OSBE-së (Action plan on improving the situation of Roma and Sinti within OSCE area. (MC.DEC/3/03), Planin e aksionit të OSBE-së për avancimin e barazisë së gjinive, Konventën kornizë të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave.

Pajtueshmëria me strategjitë dhe dispozitat ligjore nacionale

Plani i aksionit është i akorduar me Kushtetutën e Malit të Zi. Kushtetuta e Malit të Zi i mbron parimet themelore të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe garanton mbrojtjen e të drejtave politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Kushtetuta garanton edhe e një seti të të drejtave të posaçme të pakicave. Plani i aksionit është i akorduar me Ligjin mbi të drejtat dhe liritë e pakicave, Ligjin mbi ndalimin e diskriminimit dhe dispozitat e ligjeve tjera që trajtojnë të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave kombëtare në Mal të Zi.

Plani i aksionit 2020-2023 i komunës së Ulqinit është i akorduar me: Strategjinë e mbrojtjes nga dhuna në familje 2016-2020, Planin nacional të aksionit për arritjen e barazisë gjinore; Planin nacional për integrimin e Malit të Zi në BE; Strategjinë nacionale të punësimit dhe zhvillimit të resurseve njerëzore; Strategjinë për zhvillim dhe për zvogëlimin e varfërisë; Strategjinë për luftë kundër tregtisë me njerëz; Përfundimet e seminarit “Prej fjalëve në vepra drejt integritit të romëve” të mbajtur më 05 korrik 2016.

Qasja strategjike

Plani i aksionit i komunës së Ulqinit bazohet në qasjet që vijojnë:

- Qasja integruese
- Arritshmëria/realizueshmëria
- Partecipimi aktiv dhe integrimi i shoqërisë civile rome dhe egjiptiane
- Monitorimi dhe evalvimi i zbatimit
- Ndjeshmëria e posaçme për inkluzionin e grave dhe fëmijëve

Njëra nga përparësitë kyçe të propozuara me Strategji, e që janë të rëndësishme për realizimin e Planit të aksionit është **qasja integruese**. Është definuar qartë se nga efikasiteti dhe efektiviteti i masave në një fushë varet në masë të madhe edhe efikasiteti në fushat tjera dhe se të gjithë aktorët në procesin e integritit duhet medoemos të bashkëpunojnë dhe t'i shkëmbejnë informatat. Për këtë arsye, qasja bazohet në kooperativitetin e aktorëve dhe komplementarizmin e masave në të gjitha fushat.

Është me rëndësi të jashtëzakonshme **që masat të jenë realisht të arritshme**. Përvoja nga zbatimi i Strategjive planeve të përparshme të aksionit, në të cilat nuk janë paraparë në mënyrë reale kapacitetet financiare dhe të tjera për implementimin e këtyre masave, ka treguar se pikërisht projeksionet joreale kanë pamundësuar implementimin e masave të parapara.

Në implementimin e Strategjisë dhe planeve të aksionit, në mënyrë intensive **jemi mbështetur dhe mbështetemi në shoqërinë civile, e posaçërisht në OJQ-të rome dhe egjiptiane si dhe në donatorë të jashtëm**.

Në këtë kuptim, plani i aksionit bazohet në bashkëpunimin e qeverisjes lokale dhe shoqërisë civile rome si dhe në përgjegjësinë e ndërsjellët në aspektin e sigurimit të mjeteve buxhetore dhe mjeteve nga donatorët.

Gjatë definimit të Planit të aksionit i është kushtuar kujdes **monitorimit dhe evalvimit të implementimit**. Për aq më tepër, në bazë të preferencave të Kornizës së BE-së për strategjitë nacionale të integritetit të romëve deri më 2020 për politikën e bazuar në të dhënat, kështu që qëllimit janë formuluar ashtu që përcjellja dhe vlerësimi i implementimit të Planit të aksionit të bëhet në pajtim me kornizën kohore të implementimit. Në këtë mënyrë, nëse paraqitet nevoja, implementuesit mund të ndërmarrin masa për korrigjim në çdo moment të implementimit.

Pavarësisht nga evalvimi i vet implementimit të planit të aksionit është me rëndësi të bëhet **vlerësimi i efekteve të zbatimit të Planit të Aksionit (i ashtuquajtur i impact assesment)**. Për këtë qëllim, për të gjithë indikatorët kyçë të qëllimeve që dëshirohet të arrihet, është realizuar hulumtimi në bashkësinë rome dhe egjiptiane, me të cilin janë përfshirë të gjitha familjet rome dhe egjiptiane.

Falë këtyre të dhënave, pas katër vjetësh pas skadimit të afatit për implementim, do të realizohet hulumtimi me instrumente të njëjta dhe do të vlerësohet se në ç' masë, të gjitha aktivitetet e ndërmarra, përpos rezultateve afatshkurtra, kanë krijuar ndryshime reale në bashkësi dhe me kyçjen e saj.

Kujdes i posaçëm në pajtim me **Strategjinë në Planin e Aksionit u është kushtuar romëve dhe egjiptianëve në moshën fëmijërore si dhe femrave**, si kategori që me kornizën evropiane për strategjinë për romët janë identifikuar si ato grupe që kanë diskriminim të shumëfishtë. Masat që janë propozuar në këtë drejtim janë të dizajnuara posaçërisht në zgjidhjen e problematikës në sferën e mbrojtjes shëndetësore dhe të arsimimit.

PARIMET E PËRPILIMIT TË PLANIT TË AKSIONIT

Qëllimi strategjik që vendoset me këtë dokument është i definuar si përmirësim dhe avancim i pozitës së romëve dhe egjiptianëve në komunën e Ulqinit, që duhet të sjellë deri te zvogëlimi i dallimeve që ekzistojnë aktualisht ndërmjet pozitës së tyre dhe pozitës së banorëve të tjerë. Shikuar nga korniza shumë-cilësore normative e të drejtave të garantuara njerëzore dhe të pakicave në Mal të Zi, qëllimi kryesor i kësaj strategjike nuk mund të definohet edhe si krijim i kushteve për zbatimin dhe aplikimin e të drejtave themelore, njerëzore dhe të pakicave në popullatën rome dhe egjiptiane, individualisht dhe kolektivisht, në mënyrë që të përmirësohet në thelb dhe në mënyrë cilësore pozita shoqërore, kulturore, socio-ekonomike dhe çdo pozitë tjetër të këtij grupi të qytetarëve të Malit të Zi. Në këtë mënyrë do të mundësohet integrimi gradual i bashkësisë rome dhe egjiptiane në rrjedhat shoqërore të Malit të Zi, gjë që do të jetë një proces afatgjatë dhe i ndërlikuar. Integrimi i popullatës rome dhe egjiptiane përfshin edhe vendosjen e raporteve të reja shoqërore- kulturologjike ndaj bashkësisë rome dhe egjiptiane, të pasqyruara në aspektin specifik të bashkëjetesës paqësore me popullsinë shumicë si dhe në eliminimin e paragjykimeve dhe stereotipave tradicionale që e karakterizojnë marrëdhënien ndaj kësaj popullate, fatkeqësisht jo vetëm në Mal të Zi. Parimet e ndalimit të diskriminimit dhe parimi i barazisë para ligjit janë parakushte themelore për gëzimin e të gjitha të drejtave njerëzore dhe të pakicave, por, ata nuk janë të mjaftueshëm për garantimin e barazisë faktike të pakicës me shumicën, në veçanti në mbrojtjen e identitetit të posaçëm të pakicave. Për këtë arsye edhe standardet ndërkombëtare edhe legjislativi nacional e parashohin institutin e njohjes së një seti shtesë të drejtave të pjesëtarëve të pakicave që quhet aksioni afirmativ- trajtimi preferencial-diskriminimi pozitiv. Ky koncept si standard ndërkombëtar- juridik, posaçërisht në kuadër të këshillit të Evropës ka të bëjë me pakicat nacionale, etnike, racore, fetare, gjuhësore, kulturore. Ai shtrihet në pranimin e disa të drejtave në vëllim më të madh se të drejtat që i pranohen popullatës shumicë në bazë të rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Përpilimi dhe zbatimi i strategjisë bazohet në këto parime themelore, përndryshe të zhvilluara në praktikën e mbrojtjes së të drejtave njerëzore dhe të pakicave, për grupet posaçërisht të rrezikuara, të përjashtuara dhe të margjinalizuara:

- Parimi i barazisë, gjegjësisht mundësive të njëjta dhe jo diskriminimit;
- Parimi i integritetit pa asimilim;
- Parimi i aksionit afirmativ apo pozitiv;
- Parimi i respektimit, pranimin dhe promovimit të dallimeve;
- Parimi i barazisë gjinore;
- Parimi i ndihmës dhe vetë-ndihmës për qytetarët e rrezikuar dhe grupet në pozitë të pavolitshme sociale;
- Parimi i partneritetit të ndërsjellët të qeverisjeve lokale, organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe romëve dhe egjiptianëve, gjegjësisht participimi i organizatave rome dhe egjiptiane në përpilimin dhe zbatimin e strategjisë;
- Parimi i solidaritetit social apo bashkëjetesës paqësore të pakicës dhe shumicës;

- Parimi i ndarjes së përgjegjësive së aktorëve kryesorë të përpilimit dhe zbatimit të strategjisë.

Të gjitha këto parime janë të lidhura ndërmjet vetes, janë të ndërvarura, janë në gjendje të korrelacionit të lartë të ndërsjellët, gjë që do të thotë se qëllimet dhe detyrat e strategjisë mund të realizohen vetëm me zbatimin e tyre integral. Kjo gjë është plotësisht e logjikshme dhe e arsyeshme bazuar në gjendjen faktike të popullatës romë në komunën tonë dhe domosdoshmërinë e marrjes së masave urgjente dhe efektive me qëllim të shërimit të kësaj gjendjeje dhe krijimit të kushteve afatgjata që romët dhe egjiptianët të fillojnë t'i realizojnë të drejtat e tyre themelore dhe të pakicave si edhe të gjithë qytetarët tjerë të komunës së Ulqinit.

Në pajtim me Strategjinë për inkluzionin social të romëve dhe egjiptianëve në Mal të Zi 2016-2020 plani i aksionit për romë dhe egjiptianë në komunën e Ulqinit bazohet në katër parime:

- **Parimi i barazisë dhe mundësive të barabarta.** Me këtë parim respektohet nevoja që pjesëtarët e bashkësisë romë dhe egjiptiane të kenë mundësi të barabartë në të gjitha fushat shoqërore siç është rasti edhe me popullatën shumicë.
- **Parimi i mos diskriminimit.** Në këtë parim bazohen të gjitha masat në mënyrë që me zbatimin e tyre të zvogëlohet dukshëm shkalla e diskriminimit të pjesëtarëve të bashkësisë romë dhe egjiptiane në të gjitha segmentet e jetës shoqërore.
- **Parimi i desegregacionit.** Njëri nga shkaqet kyçe të përjashtimit dhe deprivimit social të romëve dhe egjiptianëve është fakti se ata në numrin më të madh të rasteve jetojnë në kushte segreguese. Në këtë mënyrë mekanizmat dhe faktorët e marginalizimit social reprodukojnë dhe pamundësojnë veprimin e masave që janë të orientuara drejt inkluzionit social.
- **Parimi i aksionit afirmativ.** Parimi i ndalimit të diskriminimit dhe barazisë para ligjit janë parakushtet themelore për jetësimin e të gjitha të drejtave njerëzore dhe të pakicave, por ata nuk janë të mjaftueshëm për të siguruar barazi faktike të pakicës me shumicën. Për këtë arsye edhe standardet ndërkombëtare- juridike si dhe legjislativi nacional parashohin institutin e njohjes së një setit shtesë të të drejtave për pjesëtarët e pakicave që quhet aksioni afirmativ- trajtimi preferencial- diskriminimi pozitiv, siç është paraparë me nenin 8.të Kushtetutës së Malit të Zi, në të cilin parashihet se nuk do të vlerësohen si diskriminim dispozitat ligjore dhe futja e masave të posaçme që janë të orientuara në krijimin e kushteve për realizimin e barazisë nacionale, gjinore dhe të përgjithshme, si dhe në mbrojtjen e personave që janë në çfarëdo baze në pozitë jo të barabartë. Masat e posaçme mund të zbatohen vetëm derisa të realizohen qëllimet për shkak të së cilave janë ndërmarrë ato.

VIZIONI

Komuna e Ulqinit është bashkësi lokale në të cilën romët/et dhe egjiptianët/et i kanë të gjitha të drejtat e garantuara me kushtetutë dhe me ligjet e Malit të Zi, kanë qasje të barabartë dhe të

njëjtë ndaj të gjitha shërbimeve dhe serviseve që u ofrohen qytetarëve dhe qytetareve në nivelin lokal.

ANALIZA SWOT

Analiza SWOT ka të bëjë me analizën e fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve në mjedis. Në tabelë është dhënë analiza e të gjithë faktorëve thelbësor që janë të rëndësishëm për miratimin e planit lokal për aksion për inkluzionin social të romëve dhe egjiptianëve, si dhe faktorëve që do të ndikojnë në vetë procesin e realizimit të aktiviteteve të definuara me plan.

<i>FUQITË</i>	<i>DOBËSITË</i>
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përvoja në realizim ▪ Plani lokal i aksionit të përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve në komunën e Ulqinit 2012-2016 ▪ Strategjia për inkluzionin social të romëve dhe egjiptianëve në Mal të Zi 2016-2020 ▪ Protokolli mbi prevenimin dhe ndalimin e martesave fëmijërore të kontraktuara ▪ Protokolli me qëllim të parandalimit të braktisjes së hershme të shkollimit ▪ Edukimi ▪ Një pjesë e bashkësisë rome dhe egjiptiane që bashkëpunojnë në mënyrë aktive me institucionet dhe me sektorin joqeveritar ▪ Fëmijët romë dhe egjiptianë si shembull, edukimi moshatar, ▪ Baza e të dhënave të Qendrës për punë sociale ▪ Përvoja e deritanishme në punë me popullatën RE ▪ Aktivitetet e komisionit për mbrojtjen nga dhuna në familje ▪ Shembujt e praktikës së mirë ▪ Interesimi i sistemit që të merret me këtë problematikë ▪ Përfshirja dhe bashkëpunimi i të gjithë aktorëve relevantë ▪ Përvoja pozitive që e bartin pjesëtarët 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Qeverisja lokale ka dy vjet që është pa dokument që do të merrej me çështjet e popullatës RE ▪ Nuk ekziston evalvimi i planit dhe punës së përparshme në të gjitha fushat ▪ Mungesa e kuadrit profesional në institucionet e sistemit ▪ Mungesa e mediatorit/ mediatores RE në shkolla ▪ Mungesa e mjeteve financiare ▪ Kapaciteti i qeverisjes lokale për informim të bashkësisë RE si dhe i popullatës shumicë rreth çështjeve të rëndësishme për këtë problematikë është joadekuat

e popullatës RE që kanë jetuar jashtë shtetit	
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përpilimi i LPA-së së ri ▪ Kyçja e të gjitha palëve të interesuara ▪ Qasja multidisiplinare ▪ Mundësia e shfrytëzimit të fondeve të jashtme, të projekteve të ambasadave, OJQ-ve të jashtme... ▪ Edukimi si proces ▪ Ngritja e nivelit të vetëdijes dhe evitimi i paragjytimeve ▪ Të futen benefite për punëdhënësit sipas shembullit që bëhet për benefite për punësim të personave me invaliditetet ▪ Përpilimi dhe realizimi i projekteve, fondet vendore dhe të jashtme 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Paragjykimet dhe stereotipat ▪ Tradicionalizmi dhe mbyllja e bashkësisë rome dhe egjiptiane ▪ Bashkëpunimi joadekuat i qeverisjes lokale dhe me një pjesë të popullatës RE ▪ Paragjykimi i punëdhënësve ▪ Mungesa e mjeteve për realizimin e aktiviteteve.

ANALIZA E SITUATËS

Numri më i madh i pjesëtarëve të popullatës rome dhe egjiptiane në territorin e komunës së Ulqinit jeton në vendbanimet Totosh, Mali i Bardhë, Pinjesh, Kodra, Gjerana, Barakat e MPB, ndërsa një pjesë e vogël e tyre i banojnë në pjesën e territorit para së gjithash në prapashpinën e Plazhit të Madh dhe Shtojit. Është me rëndësi të ceket se këto vendbanime të përmendura janë kryesisht rome dhe egjiptiane, në të cilat ata jetojnë në kushte relativisht të dobëta, në veçanti kur bëhet fjalë për kushtet e banimit.

Të dhënat e paraqitura në këtë kapitull janë të dhënat me të cilat disponon Grupi punues:

- Të dhënat zyrtare nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011
 - Të dhënat që disponojnë entet/ institucionet/ organizatat përfaqësuesit e të cilave janë anëtarët e grupit punues;
 - Të dhënat nga hulumtimi në terren
- Sipas të dhënave zyrtare të entit për statistikë të Malit të Zi, në regjistrimin e vitit 2011 në territorin e komunës së Ulqinit jetojnë 73 pjesëtarë të popullatës egjiptiane dhe 159 pjesëtarë të popullatës rome.

FUSHAT E IMPLEMENTIMIT

1. Statusi juridik

Definimi i statusit të secilit individ definojnë korpusin e të drejtave statusore që i ka në dispozicion. Posedimi i dokumenteve identifikuese paraqet parakushtin themelor për kyçje në shoqëri dhe zvogëlimin e varfërisë së popullatës romë dhe egjiptiane. Me këtë mundësohet qasje e rregullt në tregun e punës, mbrojtjen sociale, shërbimet shëndetësore dhe arsimore, si dhe të gjitha gjërave tjera që paraqesin kusht për organizimin normal të jetës. Për fat të keq, një numër i konsideruar i romëve dhe egjiptianëve si nëse bëhet fjalë për popullatën domicile ashtu edhe për popullatën e zhvendosur, nuk posedon dokumente identifikuese.

2. Arsimimi

Mundësitë dhe arritjet e arsimimit të fëmijëve, apo të individëve nuk varen vetëm nga aftësitë e tyre por edhe nga një numër i madh i faktorëve shoqëror, nga sistemi shkollor dhe politika arsimore e shtetit. Mirëpo, është me rëndësi të ceket se fëmijëve romë dhe egjiptianë u paraqiten vështirësi dhe pengesa të shumta për kyçjen e tyre në sistemin e arsimimit. Gjendja ekonomike e familjes, kushtet joadekuate të jetës, arsimimi i prindërve, vlera që i jepet në familje arsimimit, mënyra e jetës, paragjykimet, mos integrimi, janë disa nga elementet që drejtpërdrejt apo në mënyrë indirekte ndikojnë në suksesin e fëmijëve.

Të dhënat na pasqyrojnë qartas një nivel tejet të ulët të arsimimit të prindërve prej të cilëve vështirë se mund të pritet të ofrojnë mbështetje të duhur fëmijëve në arsimim, si nëse bëhet fjalë në nxitje në mësim, apo në nxitjen dhe motivimin në aktivitete të ndryshme arsimore jashtë shkollës. Përpos kësaj, gjendja materiale e familjes, kushtet joadekuate banesore, migrimi i familjeve gjatë një viti shkollor, mjedisi ku mbisundon martesë e hershme dhe themelimi i hershëm i familjes kontribuojnë gjithashtu në përjashtimin e tyre nga sistemi shkollor.

2.1. Edukimi dhe arsimimi parashkollor: Përfshirja e fëmijëve të popullatës romë dhe egjiptiane në edukimin dhe arsimimin parashkollor është 0%. Në pajtim me nenin 35 të ligjit mbi edukimin dhe arsimimin parashkollor, shërbimet e ushqimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe fëmijëve prindërit e të cilëve janë shfrytëzues të sigurimit material të familjes, i paguan Qendra për punë sociale në territorin e të cilës është vendbanimi i fëmijës, gjegjësisht i prindërve. Nuk ka automatizëm me rastin e përfshirjes së fëmijëve RE në kopsht, gjegjësisht në sigurimin e vendeve në institucionin parashkollor. Gjithashtu edhe pagesa mujore në shumën prej 40 € për këtë aspekt të arsimimit paraqet pengesë për prindërit. Ekziston mundësia që mjetet për vijimin e fëmijëve në institucione parashkollore të sigurohen nga buxheti i shtetit në bazë të strategjisë. Edukimi dhe arsimimi parashkollor ka rol të rëndësishëm në ngritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm të formimit të personalitetit të fëmijës. Pjesëmarrja e pamjaftueshme e fëmijëve në arsimimin parashkollor gjithashtu ndikon në rezultatet e dobëta të fëmijëve gjatë arsimimit të obliguar.

2.2. Arsimimi dhe edukimi fillestar: Ligji mbi arsimimin dhe edukimin fillestar përcakton se çdokush ka të drejtë në arsimimin fillestar kualitativ dhe pa pagesë. Arsimimi dhe edukimi

filleshtar është i obliguar për të gjithë fëmijët prej moshës prej 6 deri në 15 vjet. Në shkollë regjistrohen fëmijët të cilët në vitin kalendarik në të cilin fillojnë të vijnë në mësimin do t'i plotësojnë 6 vjet. Fëmijët pjesëtarë të bashkësisë rome dhe egjiptiane vijnë dy shkolla fillore në Ulqin, IP SHF "Marshall Tito" dhe IP SHF "Boshko Strugar".

Një numër më i madh në përqindje rreth 80% me 15 vjet të mbushura dhe pas ngeljes së disahershme në klasë, fëmijët e braktisin shkollimin në këtë moshë. Vetëm i numër i vogël i fëmijëve, rreth 20% sish, vazhdon shkollimin në shkollë të mesme.

Me qëllim të lehtësimit të kyçjes dhe vazhdimin të mëtejshëm të tyre të shkollimit, Ministria e arsimit në bashkëpunim me Ministrinë për të drejtat njerëzore dhe të pakicave kanë zhvilluar disa aktivitete, duke përfshirë këtu edhe librat shkollorë pa pagesë për të gjithë fëmijët romë dhe egjiptianë, që nga klasa e para deri në klasën e nëntë.

Gjithashtu, komuna e Ulqinit në periudhën e përparshme ka ndarë libra gratis për fëmijë që i kanë plotësuar kushtet për regjistrim në klasën e parë gjatë vitit, duke përfshirë këtu edhe popullatën rome dhe egjiptiane. Me qëllim të zvogëlimin të disperzimit dhe braktisjes së shkollimit të fëmijëve, shkollat fillore formojnë ekipe që me zbatimin e mekanizmit do të identifikojnë nxënësit në rizik nga braktisja e shkollimit, reagimi dhe realizimi i efikasitetit të masave të parandalimit dhe intervenimit në nivelin e shkollës.

Për avancimin e pozitës dhe pjesëmarrjen aktive të bashkësisë RE, misioni OSBE në Mal të Zi ka realizuar një projekt 4 vite me radhë, në bashkëpunim me SHF "Marshall Tito" që ka pasur për qëllim që nëpërmes të arsimit joformal, nëpërmes punishteve për gazetarë të rinj, fëmijë që vijnë nga popullata RE, t'i afrojnë më shumë fëmijëve tjerë dhe të njëjtit t'i njoftojnë se nuk ekzistojnë kurrfarë dallimesh mes tyre. Të gjithë fëmijët që kanë vijuar këtë lloj të arsimit joformal nga bashkësia RE, sot vijnë në shkollën e mesme në Ulqin dhe Podgoricë, për ç' shkak falënderimin më të madh e meriton projekti i cekur më sipër.

2.3. Arsimit dhe edukimi i mesëm: Prej nxënësve të popullatës rome dhe egjiptiane në Ulqin në këtë vit shkollor krejtësisht 10 sish kanë regjistruar shkollën e mesme në Ulqin dhe Podgoricë. Për nxënësit e regjistruar të shkollave të mesme të kësaj popullate, ministria e arsimit dhe e sportit në bashkëpunim me ministrinë e punës dhe përkujdesjes sociale, i siguron librat gratis.

2.4. Nivelet tjera të arsimit dhe edukimit: Bazuar në aktivitetet e aktorëve të ndryshëm, viteve të fundit është rritur dukshëm edhe numri i pjesëtarëve të popullatës rome dhe egjiptiane që vazhdojnë shkollimin në institucionet e shkollimit të lartë. Më së fundmi në fakultete në Mal të Zi një studente nga Ulqini, pjesëtare e popullatës RE e ka përfunduar fakultetin e shkencave politike.

Me strategjinë e zhvillimit të arsimit theksi vendoset mbi nxitjen e kualitetit më të mirë, efikasitetit dhe kyçjes së fëmijëve në sistemin e arsimit pa diskriminim në çfarëdo baze, në përmirësimin e suksesit shkollor të fëmijëve, dhe në zvogëlimin e braktisjes së shkollimit.

Kushti themelor për përmirësimin e statusit socio-ekonomik të bashkësisë RE, gjegjësisht i lëvizshmërisë shoqërore sociale dhe i integritetit në shoqëri është arsimiti. Pasi që arsimiti

është njëri nga faktorët kyçë, është e domosdoshme të punohet në evitimin e pengesave dhe kyçjen në arsim në mënyrë që të gjithë fëmijët romë dhe egjiptianë të përfshihen në sistemin arsimor, e kjo do të ndikojë në përmirësimin e pozitës së përgjithshme të kësaj bashkësie, gjegjësisht:

- Të njihen bashkësitë rome dhe egjiptiane me të drejtat dhe obligimet nga fusha e arsimit dhe mbështetja në realizimin e tyre;
- Të organizohen sa më shumë fushata për regjistrim në arsimin parashkollor, fillestar, të mesëm dhe të lartë;
- Të realizohen një sërë aktiviteteve edukative për pjesëtarët e bashkësisë rome dhe egjiptiane me qëllim të ngritjes të vetëdijes mbi rëndësinë e arsimit dhe obligimin e kyçes së fëmijëve në sistemin e arsimit;
- Organizimi i punishteve për bashkësinë RE për parandalimin e martesave të parakohshme dhe të dhunës moshatare;
- Të motivohen fëmijët me theks të posaçëm në vajza, me qëllim të nxitjes së regjistrimit, përcjelljes, vijimit të mësimin të rregullt, të suksesit më të mirë shkollor dhe të përfundimit të shkollimit.
- Të organizohen kopshtet përgatitore me qëllim të rritjes së shkallës së socializimit ndërmjet fëmijëve dhe të efikasitetit të rezultateve në arsimin fillestar.
- Të sigurohet transport gratis dhe pajisje për arsim të fëmijëve RE për eliminimin e shkaqeve të përfshirjes më të madhe;
- Kyçja e mediatorëve, asistentëve në mësim, ndihma e mentorit dhe tutorit për përmirësimin e suksesit shkollor të fëmijëve;
- Të zvogëlohen stereotipat, paragjykimet dhe diskriminimi në sistemin e arsimit;
- Të ofrohet ndihmë me rastin e sigurimit të dokumenteve personale që nevojiten për regjistrim në arsim;
- Të rriten kapacitetet e institucionit parashkollor dhe të sigurohet mbështetja financiare për funksionimin më të mirë të tyre.

3. Punësimi dhe të drejtat nga marrëdhënia e punës

Karakteristika themelore e pozitës shoqërore- ekonomike e pjesëtarëve të popullatës rome dhe egjiptiane në Mal të Zi është shkalla e ulët e aktivitetit ekonomik dhe shkalla e lartë e papunësisë. Popullata rome dhe egjiptiane kryesisht është e përjashtuar nga format formale të punësimit, ndërsa numri më i madh i personave merren me profesionet për të cilat nuk nevojitet profesion i caktuar. Një numër i madh i tyre është i punësuar në ekonominë gri, kryesisht në mbledhjen e lëndëve të para për riciklim. Për këtë arsye, popullata rome dhe egjiptiane i takon kategorisë së personave me mundësi tejet të kufizuara të punësimit, me konkurrencë dhe mobilitet të ulët në tregun e punës. Rezultatet e kyçes së romëve dhe egjiptianëve në masa të politikës aktive të punësimit në periudhën e përparshme kanë qenë inkurajuese, dhe tregojnë se ekziston interesim gjithnjë e më i madh për avancimin e statusit të deritashëm dhe për përfshirje në programe që u ofrohen nëpërmes të entit të punësimit. Ata që i kufizon angazhimet e entit dhe partnerëve të tij në fushën e arsimit dhe arsimin profesional është ekzistimi i diskriminimit

në tregun e punës në aspektin e punësimit të romëve dhe egjiptianëve pas përfundimit të programeve të arsimit dhe aftësimit profesional. Qëllimet e përgjithshme të strategjisë në fushën e punësimit janë rritja e pjesëmarrjes së pjesëtarëve të popullatës rome dhe egjiptiane në masat e politikës aktive të punësimit, me kyçjen e barabartë të grave; avancimi i mundësive për punë cilësore; rritja e shkallës së punësimit dhe ruajtja e trendit të tillë; avancimi i bashkëpunimit ndërmjet partnerëve socialë dhe shoqërisë civile; zvogëlimi i diskriminimit në tregun e punës. Përmes sigurimit të arsimit dhe aftësimit më kualitativ për romë dhe egjiptianë si masa aktive të punësimit do të ngrihet edhe niveli i punësimit të tyre dhe do të gjenerojë potencial për krijimin e të ardhurave personale gjë që do të jetë bazë fillestare për zhvillimin e ekonomisë sociale, për çlirimin nga varfëria dhe për sigurimin e anëtarësimit të plotfuqishëm në shoqëri.

Për rritjen e numrit të të punësuarve nga rendi i romëve dhe egjiptianëve, duhet të ndërmerret një sërë aktivitete:

- Organizimi i një fushate informuese mbi të drejtat dhe obligimet e popullatës rome dhe egjiptiane në fushën e punësimit me theks të posaçëm në informimin e grave (pjesëmarrja aktive e këshillit të romëve, OJQ-ve të romëve dhe liderëve të tyre);
- Motivimi i romëve dhe egjiptianëve për kërkim aktiv të punës dhe kyçja në masat e politikës aktive të punësimit nëpërmes kyçjes në biseda informative me persona të posaçë paraqitura dhe me seminare informative-motivuese;
- Promovimi i pjesëmarrësve të programeve në bashkësinë lokale;
- Sigurimi i kurseve të gjuhëve për romë dhe egjiptianë që nuk e flasin gjuhën malazeze, veçanërisht për gra;
- Organizimi i programeve që përfshin edhe shkrim-leximin funksional dhe të gjitha llojet e arsimit;
- Organizimi i programit për arritjen e kualifikimit të parë për profesion për numër sa më të madh të personave që nuk kanë aftësim profesional.
- Organizimi i programeve të certifikuara të arsimit dhe aftësimit për profesione që kërkohen në tregun e punës e të cilat i plotësojnë nevojat dhe interesimin e pjesëtarëve të popullatës rome dhe egjiptiane dhe kanë lidhje me mundësitë e ardhshme për punë;
- Kyçja e romëve dhe egjiptianëve në programe të punëve publike, dhe në punësimin sezonal, me aksent të posaçëm në sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave;
- Mbështetja e zhvillimit të biznesit familjar;
- Mbështetja e ruajtjes dhe zhvillimit të zanateve tradicionale (përmes zhvillimit të kooperativave dhe ndarjes së granteve)
- Stimulimi i punëdhënësve për punësimin e pjesëtarëve të popullatës RE, përmes sistemit të lehtësimeve afariste dhe tatimore si dhe përmes subvencioneve për romë dhe egjiptianë të ndërmarrësve dhe punëdhënësve që punësojnë punëtorë të kombësisë rome dhe egjiptiane;
- Punësimi aktiv i pjesëtarëve të popullatës rome dhe egjiptiane në sektorin publik;
- Inicimi i përpilimit të rregullativit ligjor për zhvillimin e ekonomisë sociale;
- Zhvillimi i mëtutjeshëm i dijeve dhe shkathtësive të sektorit OJQ si dhe përfaqësuesve të tyre në grupet zyrtare për punën e monitorimit të procesit të inkluzionit dhe përfaqësimit

publik me qëllim të zbatimit sa më efikas të politikave nacionale dhe lokale ndaj romëve dhe egjiptianëve;

- Fuqizimi i partneritetit social- përfshirja dhe lidhja e institucioneve ekzistuese dhe bashkësisë lokale;
- Përforcimi i koordinimit nëpërmes vendosjes së partneriteteve ndërmjet qendrave për punë sociale, byrove të punësimit, OJQ-ve dhe liderëve të RE, këshillit të romëve dhe organizatave ndërkombëtare në kontekstin e përgatitjes dhe implementimit të projekteve që i financon BE në sektorin social.

4. Shëndeti dhe mbrojtja shëndetësore

Me reformën e sistemit të shëndetësisë është futur mjeku i zgjedhur, përmes të cilit personat e siguruar realizojnë mbrojtjen primare shëndetësore dhe që u mundëson edhe drejtimin në nivelin sekondar dhe terciar të mbrojtjes shëndetësore. Ligji mbi sigurimin shëndetësor ka garantuar që kategoritë e rrezikuara sociale, të papunësuarit, fëmijët deri në shkollën fillore, e nëse janë në shkollë deri sa ta përfundojë shkollimin e mesëm dhe të lartë, gratë gjatë shtatzënisë dhe një vjet pas lindjes, të moshuarit mbi 65 vjet dhe të sëmurit nga sëmundje të ndryshme, nuk marrin Opjesë në shpenzimet e shërimit (kanë mbrojtje shëndetësore gratis). Dispozita mbi mënyrën e realizimit të mbrojtjes shëndetësore të të huajve i ka barazuar pjesëtarët e popullatës rome dhe egjiptiane në të drejtat në mbrojtjen shëndetësore me persona të siguruar (për të cilët vlen ligji mbi mbi sigurimin shëndetësor). Tani nuk ka pengesa normative që pjesëtari i popullatës rome dhe egjiptiane që nuk posedojnë dokumentet (letërnjoftimin, pasaportën apo ndonjë dokument tjetër identifikues, certifikatë të lindjes, numrin unik amëz) ta realizojnë të drejtën në mbrojtjen shëndetësore, si për nga kuantiteti, ashtu edhe për nga përmbajtja e shërbimeve si edhe personat e siguruar në mënyrë të rregullt. Për shërbimet e shëndetit seksual dhe reprodaktiv, pjesëtarët e popullatës rome dhe egjiptiane mund t'i paraqiten te gjinekologët e zgjedhur në shtëpitë e shëndetit, ndërsa lindjen mund ta realizojnë në çdo maternitet në Mal të Zi. Vaksinimi i fëmijëve të pjesëtarëve të popullatës rome dhe egjiptiane, që nuk e kanë pediatri e vet të zgjedhur dhe që nuk vijnë shkollimin bëhet në vendbanimet ku është siguruar vendosja kolektive e pjesëtarëve të kësaj popullate. Instituti për shëndetin publik herë pas here organizon fushata të vaksinimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë.

Është shumë e rëndësishme pjesa e aktiviteteve të qendrave mbështetëse në institucionet shëndetësore, me qëllim të informimit të romëve dhe egjiptianëve, e ku zbatohet prevenimi, mbrojtja dhe avancimi i shëndetit dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me këta persona t'ua përcjellin informatat e duhura mbi rëndësinë dhe avancimin e shëndetit reprodaktiv, në mënyrë përkatëse dhe të kuptueshme për ta.

Aktivitetet që duhet ndërmarrë për përmirësimin e mbrojtjes shëndetësore:

1. Të vërtetohet statusi shëndetësor i romëve dhe egjiptianëve në bazë të përcaktimit të treguesve relevantë të shëndetit, në mënyrë që të definohen masat specifike të mbrojtjes shëndetësore të kësaj kategorie të lëndueshme;
2. Të sigurohet monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes shëndetësore dhe kërkesave shëndetësore të romëve dhe egjiptianëve;
3. Të rritet qasja në mbrojtjen shëndetësore në të gjitha aspektet –qasja territoriale, kulturologjike dhe ekonomike;

4. Të nxiten dhe të orientohen pjesëtarët e popullatës rome dhe egjiptiane për zgjedhjen e mjekut personal (të gjithë ata që e kanë statusin e rregulluar në Mal të Zi: shtetasit e Malit të Zi apo të huajt me vendbanim të përkohshëm, apo të përhershëm);
5. Pjesëtarëve të popullatës rome dhe egjiptiane që nuk e kanë të zgjedhur statusin, t'u sigurohet mbrojtja shëndetësore në pajtim me Dispozitën mbi mënyrën e realizimit të të drejtave të personave të zhvendosur nga ish republikat jugosllave dhe personave të shpërngulur intern nga Kosova, që banojnë në Ulqin;
6. Të nënshkruhen marrëveshjet mbi bashkëpunim me OJQ-të që merren me çështjet e shëndetësisë së romëve dhe egjiptianëve, në aspektin e ofrimit të informatave profesionale, të besueshme dhe specifike si dhe intervenimet adekuate;
7. Të edukohen pjesëtarët e romëve dhe egjiptianëve mbi të drejtat në mbrojtjen shëndetësore, mënyrën e realizimit të drejtave, si dhe punëtorët shëndetësorë që duhet t'u sigurojnë realizimin e të drejtave në mbrojtjen shëndetësore;
8. Të sigurohen masat adekuate të edukimit për punëtorët shëndetësorë, për shkak të specifikave të këtij grupi të popullatës;

5. Mbrojtja sociale dhe e fëmijëve

Në sistemin e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve mbahet evidenca e bazuar në përkatësinë etnike, nacionale ose ndonjë përkatësie tjetër të shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale. Për shkak të problemit të cekur më sipër lidhur me mos posedimin e dokumenteve personale, që lidhet me pamundësinë e qasjes në të drejta të ndryshme, një numër shumë i vogël i familjeve rome dhe egjiptiane fiton sigurimin material të familjes, shtesat fëmijërore dhe benefitet tjera, që realizohen në bazë të dispozitave ligjore nga kjo fushë. Qëllimi themelor i Strategjisë në këtë fushë është lehtësimi i qasjes në sistemin e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve për popullatën rome dhe egjiptiane . Kjo do të arrihet me aktivitete të caktuar në periudhën e ardhshme katërvjeçare. Aktivitetet:

1. Të përmirësohet qasja dhe kualiteti i shërbimeve të qendrave për punë sociale;
2. Organizimi i fushatën informuese në vendbanimet e romëve dhe egjiptianëve mbi të drejtat dhe mënyrën e realizimit të mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve;
3. Angazhimi i mediatorëve RE për nevojat e timeve eksperte në qendrat për punë sociale dhe në institucione tjera të mbrojtjes sociale;
4. Me programe dhe aktivitete të posaçme t'u ofrohet mbrojtja personave me nevoja të posaçme të popullatës rome dhe egjiptiane;
5. Formimi i timeve mobile të përbërë nga përfaqësuesit /-et e qendrave për punë sociale, mediatorëve romë, përfaqësuesit /-et e OJQ-ve rome dhe egjiptiane, përfaqësuesit /-et e shtëpive të shëndetit, përfaqësuesit /-et e Drejtorisë së policisë për ofrimin e shërbimit të mbështetjes sociale;
6. Ndërmarrja e aktiviteteve nga ana e mediatorëve RE për fëmijët që e ndërpresin shkollimin e rregullt, me theks në vajza;
7. Prevenimi i martesave të të miturve dhe martesave të dhunshme /të kontraktuara përmes punës së ekipeve multidisiplinare në qendrat për punë sociale dhe avancimi i bashkëpunimit me institucionet shkollore;
8. Të ndikohet në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve si dhe në aktet përcjellëse nënligjore;

Dhuna në familje është formë specifike e dhunës së bazuar në gjini, që rrezikon realizimin e të drejtave dhe lirive themelore të grave. Edhe pse Mali i Zi zhvillon politikën e bazuar në parimet e mos diskriminimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, korniza ekzistuese institucionale ende nuk garanton mekanizma efikas të mbrojtjes së grave nga dhuna, që sigurojnë mbrojtje të barabartë pjesëtareve të popullatës rome dhe egjiptiane në pajtim me standardet e miratuara ndërkombëtare. SI shkaqe të mundshme njihen: mungesa e zgjidhjes sistemore në fushën e mbrojtjes së familjes, mungesa e rregullave dhe procedurave unike në veprimin me viktimat e dhunës, bashkëpunimi dhe koordinimi i pazhvilluar mjaftueshëm ndërmjet institucioneve kompetente, shkëmbimi i pamjaftueshëm i të dhënave relevante. Përpos kësaj, praktika e mbledhjes dhe analizimit sistematik të të dhënave për dhunën në familje dhe dhunën mbi gratë në kuadër të popullatës rome dhe egjiptiane nuk është mjaft e zhvilluar.

Në pajtim me këtë, nuk mund të shihet në mënyrë precize dhe të dokumentuar sa është e përhapur dhuna në familje në rrafshin e kësaj popullate, dhe as të analizohet kualiteti dhe kuantiteti i masave preventive që ndërmerren në rastet e dhunës në kuadër të kësaj popullate.

Aktivitetet që duhet ndërmarrë për përmirësimin e pozitës së grave dhe parandalimin e dhunës:

- Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave mbi rastet e shqetësimit, shqetësimit seksual dhe keqtrajtimit seksual;
- Kyçja e përfaqësueseve të popullatës rome dhe egjiptiane në ekipet lokale në terren që do të formohen / që veç janë të formuara;
- Kyçja e përfaqësueseve të popullatës rome dhe egjiptiane në implementimin dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve të përcaktuara me planet lokale të aksionit për arritjen e barazisë gjinore;
- Kyçja e preventimit të dhunës në të gjitha planet lokale të aksionit për përfshirjen e popullatës rome dhe egjiptiane;
- Mbrojtja nga martesat e dhunshme dhe të kontraktuara të të miturve dhe parandalimi i proceseve të tilla përmes zbatimit të përpiktë të dispozitave ligjore;
